



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-11629/25 datë:19.05.2025



Npi – 01/192 datë: 20.05.2023

Bazuar në: Nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 5 të Udhëzimi Administrativ të (MPL) Nr.05/2020 Për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më 29.05.2025, mori këtë:

PROPOZIM - VENDIM

**PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
KADRI EMININ ME ANËTARIN E KUVENDIT MUHAMET ADEMAJ**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -V- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 29.05.2025, _____ vendosi që të zëvendësoi, pozitën e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa, z.Kadri Emini - Davidovc nga subjekti politik (LDK), me anëtarin e Kuvendit z.Muhamet Ademaj – Petrovë, nga subjekti politik (AKR).

II

A r s y e t i m: Anëtari i Kuvendit, përkatësisht i Komitetit për Politikë dhe Financa, z.Kadri Emini, me dëshirën e tij ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa, më datën 20.05.2025, duke e lënë të zbrazur një vend në KPF-ë.

Komiteti për Politikë dhe Financa përbën një nga trupat më të rëndësishëm këshillëdhënës të Kuvendit Komunal, me kompetenca të gjera në trajtimin e çështjeve që prekin funksionimin financiar, hartimin e politikave zhvillimore dhe vlerësimin e dokumenteve strategjike komunale.

Anëtari i ri i propozuar z.Muhamet Ademaj vlerësohet se ka kapacitetin profesional dhe integritetin për të kontribuar në mënyrë konstruktive dhe aktive në punën e Komitetit. Përvoja e tij relevante dhe njohuritë në fushat që ndërlidhen me politikëbërjen lokale dhe administrimin financiar e bëjnë atë të përshtatshëm për këtë detyrë. Z.Muhamet Ademaj ka dhënë dorëheqje nga Komiteti për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm më datën 19.05.2025.

Zëvendësimi i propozuar bëhet në kuadër të kërkesës nga entiteti të cilit i takojnë anëtarët e Kuvendit Komunal që janë subjekt i këtij zëvendësimi.

Zëvendësimi i propozuar nuk ndikon në përbërjen gjinore, etnike apo politike të Komitetit dhe është në përputhje të plotë me parimet e përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë, siç përcaktohen me udhëzimin administrativ (MAPL) Nr.05/2020. Ky zëvendësim bëhet me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë institucionale dhe ngritjes së standardeve të përgjegjësisë e transparencës në vendimmarrje.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi